REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 1116/20
Datë/Datum 13.01.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 1116/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "BM Group"Sh.p.k.- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "Olti Trasing" Sh.p.k.& Beni-Dona Gr & Sinani-ING Sh.p.k " Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji" me nr. të prokurimit: 701-20-5712-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"/QKUK/, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "BM Group" Sh.p.k.- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji" me nr. të prokurimit 701-20-5712-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"/QKUK/.

II. <u>VËRTETOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji" me nr. të prokurimit: 701-20-5712-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"/QKUK/.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "BM Group" Sh.p.k.- Prishtinë, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "BM Group" Sh.p.k.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.12.2020 me nr. 1116/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji" me nr. të prokurimit: 701-20-5712-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"/QKUK/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 28.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:
Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:
Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, me arsyetimin se:

"lidhur me dokumentacionin/deshmit e prezentuara nga grupi i operatorve ekonomik i rekomanduar për kontratë respektivisht deshmit që nderlidhen kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kerkeses qe nderlidhen me deshmit listen e kontratave me arsytimin se e njejta nuk përmban datën e fillimit dhe përfundimit të aktiviteteve si dhe vlerën e kontratave te ngjajshme(ndertime te larta) te realizuara ne minimum prej 500,000.00 € gjatë tri viteve të fundit, sipas kërkesës së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit"

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese është i bazuar sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes se tenderit ka parashtruar kërkesen si vijon:

Kërkesa:

1."Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 5,000,000.00 €."

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 5,000,000.00 €. Lista duhet ti permbaje te dhenat si Daten e nenshkrimit, Daten e perfundimit, Titullin e Kontrates, Autoritetin Kontraktues, Vleren e projektit."

Ndërsa, grupi i OE të rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listat e projekteve të realizuara nga secili anëtar i grupit mirëpo asnjëra nga këto lista nuk është konform kërkesës së parashtruar nga AK sepse në këto lista nuk është paraqitur Data e nenshkrimit dhe Data e perfundimit të kontratave por vetëm janë paraqitur vitet e fillimit dhe vitet e mbarimit te kontratave e për disa kontrata është përshkruar vetëm një "vit" pa cekur se a është viti i fillimit apo përfundimit të kontratës.

Po ashtu Eksperti Shqyrtues sqaron se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nga AK ka bashkangjitur listat e projekteve të realizuara në të cilat kanë përfshirë kontrata të realizuara nga viti 2008 deri në vitin 2020, dhe nëse mblidhen vlerat e kontratave të paraqitura në listat e tyre atëherë vlera e përbashkët për kontratat e paraqitura respektivisht realizuara nga grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë është e barabartë me 40,026,404.45€, mirëpo AK ka bërë publikimin e këtij aktivitet të prokurimit me datën 28.09.2020 dhe kërkesa ka qenë që operatoret ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi

që kanë përfunduar kontrata të ndërtimit të larte me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të përcjellura me referenca apo raporte pranimi, ndërsa grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë përveç vlerave të atyre kontratave që nuk i përkasin periudhës së 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit për kontratë që përfshin periudhën 28.09.2017-28.09.2020, po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë në fjalë për periudhën e fundit 3 vjeçare në lista kanë përfshirë vlerat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me renovime, furnizime, montime, kontratat e kompleksève banesore pa pranime teknike nga institucione kompetente –komisione profesionale të Komunave-Bashkive (por janë bashkangjitur raporte të inxhinierëve për vetë OE) si dhe shumë vlera të kontratave të cilat janë në implementim e sipër (të pa përfunduara), të gjitha këto kontrata respektivisht vlera të këtyre kontratave nuk janë konform kërkesës së parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga AK, me të cilën kërkesë është kërkuar nga operatoret ekonomik që të ofrojnë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduara me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellura me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 5,000,000.00 €.

Po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se qëndron fakti i cekur nga OE ankuese se në listat e projekteve të realizuara të paraqitura nga lideri i grupit të OE të rekomanduar për kontratë "Olti Trasing" Sh.p.k. dhe anëtari i grupit " Sinani-ING" Sh.p.k janë përfshirë vetëm disa projekte të cilat kanë përfunduar dhe për te cilat janë bashkangjitur referenca/pranime teknike si dhe i takojnë periudhës së fundit 3 vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë respektivisht që janë brenda periudhës 28.09.2017 deri 28.09.2020, këto projekte janë:

1. Ndërtimi i një etazhe (nen kulem) në DR.Ferizaj Salla operative 98,840.98€
2. Ndërtimi i pikës O në Burgun e siguris së lartë 64,531.02€
3. Ndërtimi i aneksit te objektit të Gjimnazit "Hamdi Berisha" Malishevë 256,060.67€
4. Ndërtimi i katit të tretë në DR Prizren 219,226.36€
5. Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it LOT 10 1,643,051.43€
6. Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it punë të pa parapara Aneks Kontratë 38,022.36€
7. Ndërtimi i Prokuroris Themelore Gjakove 493,092.35€
8. Ndërtimi i shkollës fillore ne Muzeqin 659,989.80€
9. Ndërtimi i shkollës fillore "Afrim Buqaj" ne fsh.Lladroc 278,801.79€
10. Aneks kontrata Ndërtimi i shkolles fillore "Afrim Buqaj" ne fsh.Lladroc 27,877.34€

Vlera totale e këtyre kontratave është =3,779,494.10 €

Mirëpo vlera e këtyre kontratave të cilat janë konform kërkesës së parashtruar nga AK nuk e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit në minimum 5,000,000.00 €.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankuese, "që ndërlidhen me dëshmitë respektivisht kërkesat e përshtatshmërisë profesionale respektivisht certifikatat e regjistrimit te biznesit, numrit fiskal dhe TVSH e anëtarit të grupit të OE të rekomanduar për kontratë respektivisht OE "Beni Dona Gr" duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **është i bazuar** sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar për OE "Beni Dona Gr" një kopje të "Ekstraktit historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit" Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" e cila ka datë të lëshimit 28.06.2020, mirëpo nuk ka as nënshkrim të zyrtarit dhe as vulë të institucionit për ta dëshmuar se dokumenti është lëshuar nga institucioni kompetent dhe si i tillë ky dokument nuk është konform kërkesës së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ku është kërkuar që operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të dorëzojnë dëshmitë respektivisht kopjet e certifikatës së biznesit, kopjen e numrit fiskal dhe kopjen e certifikatës së TVSH, ndërsa sipas legjislacionit dhe praktikave për prokurim publik, në rastet kur ofertohet si grup operatoresh, të gjithë anëtarët e grupit duhet të plotësojnë veç e veç kërkesat e përshtatshmërisë profesionale.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së me arsyetimin se: "AK ka rekomanduar dhe favorizuar për kontratë grupin e OE të papërgegjshëm duke diskriminuar ofertën tonë financiare më çmim më të lirë se sa oferta tjera të përgjegjshme administrativisht" duke u bazuar në përgjigjet e pretendimeve të cekura më lartë dhe faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **është i bazuar** sepse AK, ka rekomanduar për kontratë grupin e OE të cilët nuk i plotësojnë kërkesat e parashtruara nga vetë AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, me këtë veprim AK ka vepruar në kundërshtim me kriterin "çmimi më i lirë" të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe me paragrafin 1.1 te pikës 1 të nenit 60 të LPP-së ku thuhet se: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues me datë 29.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk

pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 29.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "BM Group" Sh.p.k.- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, me arsyetimin se "lidhur me dokumentacionin/dëshmitë e prezantuara nga grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë, respektivisht dëshmitë që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht listën e kontratave me arsyetimin se e njëjta nuk përmban datën e fillimit dhe përfundimit të aktiviteteve, si dhe vlerën e kontratave të ngjashme (ndërtime të larta) të realizuara në minimum prej 5,000,000.00 € gjatë tri viteve të fundit, sipas kërkesës së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit".

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe kontratave të grupit të OE të rekomanduar për kontratë sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë :

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2
Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 5,000,000.00 €.
Dëshmia e kërkuar dokumentare: **Dëshmia 1.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 5,000,000.00 €. Lista duhet ti permbaje te dhenat si Daten e nenshkrimit, Daten e perfundimit, Titullin e Kontrates, Autoritetin Kontraktues, Vleren e projektit.

Paneli Shqyrtues kontaton se Grupi i Operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë ka prezantuar:

vetëm Lideri i Grupit **"Olti Trasing" Sh.p.k.** ka paraqitur një liste te kontratave ne vlere prej 30,251,554.96€, ndërsa te veçuara ne tre vitet e fundit kontrata ne vlere prej **7,066,245.85 €,**
ndërsa anëtari tjetër i grupit **"Beni Dona Group" Shpk** ka prezantuar listën me vlere prej **3,351,691.65€,**
ndërsa anëtari tjetër i grupit **"Sinani - Ing" Shpk** ka prezantuar listën me vlere prej **6,423,163.84 €,**
ku sipas listës se kontratave te prezantuar nga Grupi i Operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë ka prezantuar vetëm liderit te grupit shihet qarte se pozicione te ngjashme ka kryer edhe mbi vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "BM Group" Sh.p.k.- Prishtinë, që ndërlidhen me dëshmitë respektivisht kërkesat e përshtatshmërisë profesionale respektivisht certifikatat e regjistrimit te biznesit, numrit fiskal dhe TVSH e anëtarit të grupit të OE të rekomanduar për kontratë, respektivisht OE "Beni Dona Gr". Paneli Shqyrtues sqaron se anëtari i grupit të OE të rekomanduar ka dorëzuar dokumente shtesë, ku ka bashkangjitur dokumentin me titull "Vërtetim i kryerjes së aplikimit" të datës 19.03.2015 pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrit në Shqipëri, certifikatë regjistrimit të lëshuar me datë 11.07.2016 nga Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri, Ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" të datës 14.04.2015, ku këto dokumente janë të nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës të autoriteteve përkatëse dhe me datë të lëshimit të cekur si më lart.

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues "BM Group" Sh.p.k.- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së me arsyetimin se AK ka rekomanduar dhe favorizuar për kontratë grupin e OE të papërgjegjshëm duke diskriminuar ofertën tonë financiare më çmim më të lirë se sa oferta tjera të përgjegjshme administrativisht". Paneli Shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që grupi i OE të rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e AK-së, atëherë AK nuk ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi kjo dispozitë përcakton se AK do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti